

NJOFTIM PËR SHTYP

Botues: DIHA – Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri

Datë: 13.05.2024

Kontakt: DIHA, +355 (0) 4 222 71 46, info@diha.al

Mungesa e fuqisë punëtore shoqërohet me ngadalësim të rritjes ekonomike.

Rezultatet e anketimit vjetor të Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) për klimën e biznesit dhe investimeve në Shqipëri

Në anketimin mbi klimën e biznesit, i cili u plotësua nga kompanitë anëtare të DIHA-s në periudhën shkurt-mars 2024, **situata aktuale ekonomike në Shqipëri vlerësohet në rritje nga viti i kaluar**, ku vihet re se 45% e kompanive e vlerësojnë situatën ekonomike si **“të kënaqshme”**. Gjithashtu, **22%** e të anketuarve e vlerësojnë situatën me **“mirë”**, dhe **33%** e të anketuarve e vlerësojnë atë **negativisht**. (2023: 18%, 36%, 45%).

Pritshmëritë për situatën ekonomike në vend vijojnë të mbeten afërsisht në të njëjtat nivele me vitin e kaluar, ku **22%** e të anketuarve vlerësojnë pritshmëritë për situatën ekonomike me **“mirë”**, **51%** e kompanive vlerësojnë si **“të pandryshuar”**, ndërsa **27%** e tyre e vlerësojnë **negativisht** (2023: 25%, 45%, 30%).

Situata ekonomike e sektorit vlerësohet gjithashtu afërsisht e njëjtë me vitin e kaluar, ku **24%** e të anketuarve e vlerësojnë me **“mirë”**, ndërkohë që **38%** e vlerësojnë si **“të kënaqshme”** dhe **38%** e vlerësojnë **negativisht**. (2023: 27%, 41%, 32%). **Pritshmëritë për situatën ekonomike sipas sektorit** vlerësohen nga **30%** e të anketuarve në rritje, nga **48%** si **“të pandryshuar”** dhe nga **22%** vlerësohen **negativisht**. (2023: 34%, 39% dhe 27%)

Për sa i përket **ecurisë së pritshme të të ardhurave të biznesit** të tyre, **32%** e të anketuarve presin **rritje** të të ardhurave, ndërkohë që **30%** mendojnë se ato do të qëndrojnë **të pandryshuara**. Ajo që vihet re, në ndryshim me dy vitet e kaluara, është se **një përqindje e lartë** prej **38%** besojnë se të ardhurat e biznesit të tyre **do të ulen**. (2023: 50%, 32%, 18%)

Situata për vetë bizneset vlerësohet nga **27%** e të anketuarve me **“mirë”**, **51%** e kompanive e vlerësojnë si **“të pandryshuar”**, ndërsa **22%** e tyre e vlerësojnë **negativisht** (2023: 39%, 41%, 20%).

Ecuria e investimeve kapitale, ecuria e eksporteve dhe zhvillimi i parashikuar i numrit të punonjësve, vlerësohen nga më shumë se gjysma e të anketuarve të qëndrojnë **“të pandryshuara”**, pra në një rritje të konsiderueshme, përkatësisht me **49%**, **57%** dhe **54%** (2023: 41%, 40%, 48%).

Faktorët, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e një destinacioni investimesh, të vlerësuar **më pozitivisht** në krahasim me vitin e kaluar përfshijnë **infrastrukturën, disponueshmërinë dhe cilësinë e furnitorëve lokalë, negociatat për anëtarësimin në BE, arsimimin akademik si edhe fleksibilitetin në të drejtën e punës**. Ndër faktorët e vlerësuar **më negativisht** vijojnë të renditen **transparenca e tenderave publike, lufta kundër kriminalitetit dhe korrupsionit, parashikueshmëria e politikave ekonomike, disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe siguria ligjore**.

Kjo përforcohet edhe nga përgjigjja ndaj pyetjes **“Ku i shikoni rreziqet më të mëdha në zhvillimin ekonomik të kompanisë suaj në 12 muajt e ardhshëm?”**, ku **“Mungesa e forcës së punës”** dhe **“Kostot e punës”** vlerësohen si rreziqet më të mëdha për biznesin.

Ambasadori Gjerman, z. Karl Bergner, tha në nisje të aktivitetit:

“Gjermania është një partner afatgjatë dhe i besueshëm i Shqipërisë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Zhvillimi ekonomik i vendit është në këtë rrugëtim po ashtu një përpjekje e madhe. Gjermania mbështet Shqipërinë në mënyrë intensive dhe gjithashtu në shumë nivele: përmes mbështetjes së integritetit rajonal të Shqipërisë, përmes këshillimit të Qeverisë Shqiptare në grup-kapitujt mbi tregun e brendshëm si pjesë e

negociatave për anëtarësim në BE, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë në sektorët e energjisë, ujit, zhvillimit të qëndrueshëm urban, arsimit profesional, startup-eve dhe inovacionit. Megjithatë, për të rritur atraksionin e Shqipërisë si vend për investime ekonomike edhe nga Gjermania, nevojiten përpjekje të vazhdueshme nga të gjitha palët në krijimin e një klime pozitive investimi si dhe sigurimin e një fushe loje të barabartë për investitorët.”

Presidentja e DIHA-s Zj. Stephanie Sieg-Farka mbajti fjalën e saj përshëndetëse dhe theksoi se rezultatet e anketës së fundit ekonomike tregojnë se pritshmëritë e kompanive anëtare mbeten përgjithësisht të qëndrueshme, por mungesa e vazhdueshme e fuqisë punëtore dhe rritja e kostove të punës mbeten shqetësime kryesore për biznesin. Megjithatë, pavarësisht sfidave rajonale dhe globale, vendi duhet të vazhdojë të fokusohet tek integrimi në Bashkimin Evropian.

Mbi anketimin

Nga data 19 shkurt deri më 15 mars 2024, Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, së bashku me 16 Dhoma Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) në **Rajonin e Europës Qendrore dhe Juglindore (EQJL)**, realizoi me kompanitë anëtare anketimin vjetor mbi klimën e biznesit dhe investimeve në Shqipëri. Nga të gjitha zyrat (AHK) të rajonit EQJL morën pjesë në këtë anketim **1533 kompani**. Pjesëmarrësit marrin pjesë në këtë anketim online dhe përgjigjet analizohen në mënyrë anonime. Tematika dhe gama e pyetjeve është për të gjitha vendet njësoj.

Rreth Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) është një shoqatë e pavarur, e krijuar nga kompani të ndryshme në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Tiranë.

DIHA përfaqëson interesat e biznesit gjerman në Shqipëri. Ajo nxit marrëdhëniet bilaterale të biznesit dhe këshillon kompanitë gjermane dhe shqiptare në lidhje me bashkëpunime të mundshme dhe kërkime tregu. DIHA është e lidhur me rrjetin e Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK). AHK ka në të gjitha vendet, të cilat janë me interes për ekonominë gjermane. Deri më tani numërohen 93 shtete me mbi 150 zyra përfaqësie në të gjithë botën (www.ahk.de).